



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.9

7 shkurt

2007

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr.5198 datë 29.1.2007	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare 135
Dekret nr.5199 datë 2.2.2007	Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme në zonën zgjedhore nr.26 136
Vendim i GJK nr.5, datë 26.1.2007	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.21, datë 14.5.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit); nr.356, datë 14.7.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; nr.48, datë 4.3.2005 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe nr.546, datë 4.5.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën..... 136
	Marrëveshje bashkëpunimi 140

DEKRET
Nr. 5198, datë 29.1.2007

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|-----------------------------------|--|
| 1. Flora Kleanthi Rauls (Kospiri) | 22. Artjan Sefulla Terpollari |
| 2. Marinela Jak Plank (Kurti) | 23. Amanda Edmond Bardhi |
| 3. Esmerina Kujtim Rexhepi (Kaso) | 24. Brian Edmond Bardhi |
| 4. Kevin Arjan Rexhepi | 25. Sabeta Xhelil Wölfel (Manuka) |
| 5. Atnand Zeqir Çiku (Ciku) | 26. Vojsava Ejell Nikaj (Cekaj) |
| 6. Feliks Gjon Pasko | 27. Irena Sigurim Kapaj (Dervishi) |
| 7. Alma Ahmet Bellova (Jazoj) | 28. Caroline Syrja Kapaj |
| 8. Florinde Ejell May (Dodaj) | 29. Patric Syrja Kapaj |
| 9. Leonar Ahilea Zhupa | 30. Leonida Hamit Murati (Cami) |
| 10. Albana Gani Shkalla | 31. Florian Leorant Murati |
| 11. Arben Hazir Demiri | 32. Isabella Ilir Muka |
| 12. Aida Eshref Demneri | 33. Ervin Lutfi Saraj |
| 13. Akil Arben Goxhaj | 34. Andon Thoma Dhima |
| 14. Gëzim Jusuf Kupi | 35. Edvin Baftjar Novruzaj |
| 15. Gentian Bashkim Maska | 36. Aulona Baftjar Novruzaj |
| 16. Ilir Enver Draçini | 37. Besnik Halil Zenuni |
| 17. Elsa Shefqet Gjeta | 38. Gojart Besnik Zenuni |
| 18. Aleksandra Aleks Goga | 39. Dijana Medi Zenuni (Bylykbashi) |
| 19. Tom Shukri Vasku | 40. Sibora Besnik Zenuni |
| 20. Pandeli Jazo Ngjela | 41. Rudina Petrit Czarnotta (Alimehmeti) |
| 21. Rita Osman Ebner (Mane) | |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr. 5199, datë 2.2.2007

PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE TË PJESSHME NË ZONËN ZGJEDHORE
NR.26

Në bazë të nenit 92 germa “gj” të Kushtetutës dhe të nenit 14 pika 3 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

DEKRETOJ:

Neni 1

Zgjedhjet e pjesshme për deputet, në zonën zgjedhore nr.26, të zhvillohen ditën e dielë, datë 11 mars 2007.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr. 5, datë 26.1.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Piloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datat 15.9.2006 dhe 26.9.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.32/3 Akti, që i përket:

KËRKUES: MITIKA BURNAZI

SUBJEKT I INTERESUAR: PETRO STEFANI, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr.21, datë 14.5.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit); nr.356, datë 14.7.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; nr.48, datë 4.3.2005 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe nr.546, datë 4.5.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimeve të mësipërme:

- Vendimi nr.21, datë 14.5.2003 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit) është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor, sepse gjykimi i çështjes është bërë pa u vënë në dijeni kërkuesi për kërkesën e rishikimit dhe për gjykimin e kësaj kërkesë nga ana e atij Kolegji.

- Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesës për rishikim, të subjektit të interesuar, është bërë tej afateve të parashikuara në nenin 496 të Kodit të Procedurës Civile, për paraqitjen e kësaj kërkesë.

- Vendimet e dhëna pas pranimit të kërkesës për rishikim mbështeten në një vendim antikushtetues, prandaj edhe ato duhet të shfuqizohen.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Kujtim Puto, kërkuesin që kërkoi pranimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me kërkesën e subjektit të interesuar, Petro Stefani, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit), me vendimin nr.21, datë 14.5.2003, ka vendosur pranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit nr.341, datë 4.8.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, prishjen e këtij vendimi, si dhe të vendimeve nr.151, datë 27.4.2001 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe nr.1206, datë 10.12.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që e kanë lënë atë pjesërisht në fuqi, duke e dërguar çështjen për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Nga gjykimi i çështjes rezultoi se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin e mësipërm nr.21, datë 14.5.2003, ka pranuar kërkesën për rishikim të subjektit të interesuar, pa i dërguar kopjen e saj kërkuesit dhe pa e kaluar çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore.

Në çështjen në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese konfirmon edhe një herë qëndrimet e mbajtura në vendimet e saj nr.17, datë 18.7.2005 dhe nr.8, datë 2.5.2006, sipas të cilave kemi cenim të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt gjyqësor, në rastet kur kërkesa për rishikim nuk i dërgohet palës tjetër dhe kur nuk thirret ajo për t'u dëgjuar në Gjykatën e Lartë. Në këto kushte, palët legjitimohen të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.

Sipas neneve 134/1, shkronja "g", dhe 131, shkronja "f", të Kushtetutës, individët legjitimohen të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për shqyrtimin e ankesave të tyre nëse këto ankesa përmbajnë pretendime për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ankuesit i kanë shterrur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Kërkesa për rishikim është një mjet i jashtëzakonshëm ankimi për goditjen e vendimeve të formës së prerë, e cila jo vetëm shqyrtohet drejtpërdrejt nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, por pas prishjes së vendimit nga kjo e fundit, pala në proces, e cenuar nga prishja e vendimit, nuk ka asnjë mundësi e mjet procedural të kundërshtojë argumentet e palës tjetër dhe pranimin e kërkesave të kësaj pale nga Gjykata e Lartë.

Neni 494 i Kodit të Procedurës Civile ka përcaktuar rastet e shkaqet e rishikimit të një vendimi që ka marrë formë të prerë dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e prish vendimin e formës së prerë kur ato vërtetohen në gjykim. Në çështjen në shqyrtim kolegji, në vendimin nr.21, datë 14.5.2003, ka pranuar se prova shkresore e paraqitur nga kërkuesi "ka rëndësi esenciale për zgjidhjen e çështjes", se ajo "është zbuluar rishtas" dhe se ajo "nuk mund të dihej nga kërkuesi, gjatë shqyrtimit të çështjes nga ana e gjykatës".

Në rastin në shqyrtim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë pranoi kërkesën, duke bërë vlerësimin e provave jo thjesht në këndvështrimin e zgjidhjes në themel të çështjes, por në vlerësimin e tyre në raport me kërkesat e nenit 494/a të Kodit të Procedurës Civile. Për këtë gjykim dhe për konkluzionet e gjykatës në përgjigje të kërkesave të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, kërkuesi nuk ka mjet tjetër ankimi të efektshëm për të kundërshtuar cenimin e parimeve të një procesi të rregullt që ka sjellë si pasojë prishjen e vendimit.

Edhe pse çështja kthehet për rigjykim, procesi gjyqësor do të vazhdojë lidhur me themelin e çështjes, por jo për pretendimet për kushtet ligjore të rishikimit në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë. Këtë arsyetim e ka pranuar edhe vetë Gjykata e Lartë në vendimin nr.546, datë 4.5.2006 me rastin e shqyrtimit të rekursit pas rigjykimit të kësaj çështjeje, duke pranuar se “edhe pretendimet lidhur me zbatimin e gabuar nga kolegji civil të kërkesave të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile në dhënien e vendimit nr.21, datë 14.5.2003, me të cilin është pranuar kërkesa për rishikimin e vendimit, nuk përbëjnë objekt shqyrtimi në këtë gjykim në Gjykatën e Lartë.

Ashtu siç është shprehur edhe Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (çështja Ahdivar, etj. – kundër Turqisë; vendimi nr.21893, datë 16.9.1996, vëllimi 1996 – IV) “shtërrimi i mjeteve nënkupton që kërkuesi t’i drejtohet mjeteve që janë efektive dhe të mjaftueshme për të realizuar ndreqjen e shkeljeve të lejuara”. Këto pretendime, përse i përket kërkesave të ligjit procedural e material për rishikimin, mund të mos jenë efektive kur paraqiten në gjykatë gjatë rishqyrtimit të çështjes, përderisa nuk pranohen të vihen në diskutim nga këto gjykata. Jo vetëm kaq, por respektimi i parimit kushtetues të procesit të rregullt nuk mund të pranohet se fillon vetëm në rigjykimin e çështjes në gjykatën e rrethit. Ky parim është i detyrueshëm të respektohet në të gjitha proceset ku vihen në lojë të drejtat e fituara dhe siguria juridike që rrjedh prej tyre.

Kërkuesi ka parashtruar gjithashtu se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk i ka komunikuar atij kopjen e kërkesës së palës tjetër për rishikim.

Lidhur me këtë pretendim, Gjykata Kushtetuese thekson edhe një herë se e drejta e palës për t’u njoftuar për argumentet e faktet e parashtruara në ankimin e palës tjetër, është pjesë e së drejtës së individit për një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet së cilës atij i krijohet mundësia të përgatisë mbrojtjen e vet e të parashtrorjë argumentet ndaj pretendimeve të palës tjetër. Neni 442 i Kodit të Procedurës Civile e përcakton kërkesën për rishikim si mjet ankimi, ndërsa neni 447 i tij nuk e përjashton Gjykatën e Lartë nga detyrimi që ka gjykata për t’ia njoftuar këtë kërkesë për rishikim palës tjetër, pavarësisht nga fakti se çështja do të shqyrtohet në dhomën e këshillimit apo do të kalojë për shqyrtim në seancë gjyqësore.

Nga materialet e çështjes rezulton se Gjykata e Lartë ka vendosur në dhomën e këshillimit prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, si dhe të vendimeve të tjera që e kanë lënë në fuqi pjesërisht këtë vendim.

Nga përmbajtja e dispozitave të Kodit të Procedurës Civile për rishikimin rezulton se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit verifikon nëse kërkesa është bërë brenda afateve procedurale, nëse kërkesa është bërë nga ata që e kanë këtë të drejtë, nëse kërkesa është në tërësi e mbështetur në ligj e në prova, etj. Dhoma e këshillimit paraqitet si organizëm që bën seleksionimin e kërkesave, d.m.th. nëse janë paraqitur shkaqe për kalimin në seancë. Nëse kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, dhoma e këshillimit vendos mospranimin e kërkesës, por kur ato plotësohen, gjykata nuk mund të vendosë drejtpërdrejt prishjen e vendimit pa respektuar parimet kushtetuese e sidomos ato të dëgjimit të drejtpërdrejt të palëve e të barazisë së mundësive e të mjeteve.

Në rastin në shqyrtim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, ka vendosur prishjen e vendimit të formës së prerë vetëm mbi bazën e pretendimeve të subjektit të interesuar të parashtruara në kërkesën e vet dhe pa dëgjuar pretendimet e kërkuetit lidhur me dobishmërinë e rëndësinë e provave të paraqitura për çështjen në gjykim, si dhe për mundësinë e marrjes e paraqitjes së tyre në gjykimet e zhvilluara. Në këtë mënyrë, ai është vënë në pozitë krejtësisht të pafavorshme në raport me palën tjetër.

Ashtu siç theksohet edhe në vendimin nr.8, datë 2.5.2006 të Gjykatës Kushtetuese, e drejta për një proces të rregullt gjyqësor përfshin edhe nocionin se të dyja palët në proces kanë të drejtë të kenë informacion për faktet e argumentet e palës kundërshtare dhe që secila prej tyre të dëgjohet nga gjykata mbi bazën e parimit të barazisë së armëve apo të kontradiktoritetit në gjykim. Shqyrtimi i çështjes dhe nxjerrja e konkluzioneve nga gjykata vetëm mbi bazën e provave të paraqitura nga një palë pa dëgjuar pretendimet e komentet e palës tjetër, është shoqëruar në çështjen në shqyrtim me prishjen e vendimit të formës së prerë, pra me cenimin e gjendjes juridike të krijuar dhe të së drejtës së fituar më parë.

Këto të drejta nuk mund të cenohen pa u respektuar të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim.

Pas vendimit nr.21, datë 14.5.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, me të cilin është pranuar kërkesa për rishikim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka shqyrtuar çështjen përsëri dhe ka dhënë vendimin nr.356, datë 14.7.2004, që është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr.48, datë 4.3.2005. Të dyja këto vendime të fundit, ashtu si edhe vendimi nr.546, datë 4.5.2006 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, me të cilin nuk është pranuar rekursi i kërkuesit kundër vendimeve të gjykatave të rrethit e apelit, janë dhënë mbi bazën e vendimit të Gjykatës së Lartë, i cili siç arsyetua më lart ka cenuar parimet kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Si rrjedhojë edhe këto vendime duhet të shfuqizohen dhe çështja duhet dërguar në Gjykatën e Lartë për rishqyrtimin e kërkesës për rishikim, të subjektit të interesuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr.21, datë 14.5.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit); nr.356, datë 14.7.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; nr.48, datë 4.3.2005 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe nr.546, datë 4.5.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit).

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Jemi kundër vendimit, duke parashtruar këto arsye:

Ashtu si me të drejtë pranohet në teori, “procesi i rregullt ligjor nuk është një e drejtë universale që i mbulon të gjitha të drejtat e tjera kushtetuese të individit; ai është vetëm një procedurë e rregullt gjyqësore, në të cilën testohen të gjitha të drejtat e tjera”.¹

Këtë kuptim ka edhe neni 42 pika 1 i Kushtetutës, i cili procesin e rregullt ligjor e përcakton si një mjet kushtetues që garanton të drejtat themelore, si atë të lirisë, pronës ose të drejta të tjera të njohura me Kushtetutë apo me ligj.

Duke analizuar sa më sipër e duke u ballafaquar me vendimin e shumicës, kemi arritur në konkluzion se procesi i rregullt ligjor ka anën e vet formale, ashtu si dhe anën substanciale. Nga pikëpamja formale, procesi i rregullt ligjor konceptohet gabimisht si qëllim në vetvete, si një e drejtë kushtetuese që mund të qëndrojë më vete, pa u lidhur me të drejtat konkrete që garanton. Këtij qëndrimi formal nuk i ka shpëtuar vendimi i shumicës.

E thënë shkurtimisht, ideja e kërkesës dhe e vendimit ka qenë: shqyrtimi i kërkesës për rishikim nuk iu nënshtroa një procesi të rregullt e më konkretisht në shqyrtim nuk u thirr kërkuesi për të parashtruar pikëpamjet e tij lidhur me provat e paraqitura ku mbështetej kërkesa për rishikim. E marrë në veçanti kjo fazë, është evidente shkelja në proces. Por, më e rëndësishmja, thelbësorja është: a cenoi kjo shkelje të drejtat që pretendon të mbrojë kërkuesi (të drejtën pasurore)? Ne mendojmë se jo.

¹ K.Traja “Drejtësia Kushtetuese”, faqe 263

Kjo për shkak se ato ç'ka do të përbënin prapësim në procesin në Gjykatën e Lartë janë ezauruar nga kërkuesi tërësisht në të gjitha shkallët e gjykimit, në rishqyrtimin e çështjes e për të cilat është dhënë përgjigje në këto gjykime.

Pa marrë parasysh specifikën e këtij gjykimi, të parashtruar më sipër, shumica ka marrë vendim për të shfuqizuar të gjitha vendimet që dalin nga këto gjykime, e për të filluar përsëri një zinxhir të ri gjykimesh vetëm për një shkak, thellësisht formal, atë që të thirret kërkuesi nga Gjykata e Lartë e të dëgjohen pretendimet (prapësimet) e tij (të cilat ai i ezauroi gjatë gjykimeve dhe që gjykatat i vlerësuan si të pambështetura).

Veç sa më sipër, lidhur me kuptimin formal të procesit të rregullt ligjor, në këtë çështje shumicës duhej t'i kishte tërhequr vëmendjen edhe thjesht fakti se vlera e objektit të këtij konflikti të stërzgatur e që do vazhdojë të zgjatet zor se do të mbulojë qoftë edhe minimalisht shpenzimet gjyqësore?!?, e që për më tepër nuk do të sjellë asnjë risi në jurisprudencën kushtetuese.

Anëtarë: K. Peçi, A. Karamuço

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Sot, më datë 30.1.2007, midis Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe Korporatës Elektronergjetike Shqiptare (KESH), të quajtura Palë, këtu dhe më poshtë, në përputhje me statusin e tyre institucional, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi, nënshkruhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi.

Palët në këtë Marrëveshje bien dakord sa më poshtë:

Neni 1

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është angazhimi i Palëve, të udhëhequra nga vullneti për të respektuar dhe zbatuar ligjin, për krijimin e kushteve sa më optimale lidhur me ndriçimin e pandërprerë të godinave të objekteve zgjedhore, në funksion të zhvillimit të zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Neni 2

Palët në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi veprojnë në përputhje me ligjin nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike".

Neni 3

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare merr përsipër të furnizojë me energji elektrike, nëpërmjet linjave të saj, në mënyrë të pandërprerë, të gjitha objektet zgjedhore në të gjithë territorin e vendit, si më poshtë:

1. Godina e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (Pallati i Kongreseve Tiranë), gjatë gjithë periudhës zgjedhore.
2. Godinat e magazinave në fshatin Lundër, komuna Farkë, Tiranë gjatë gjithë periudhës zgjedhore.
3. Godinat e qendrave të votimit në të gjithë territorin e vendit, nga ora 08:00 e datës 17 shkurt 2007 deri në orën 24:00 të datës 18 shkurt 2007.

4. Godinat e KZQV-ve dhe vendet e numërimit të votave në të gjithë territorin e vendit, nga ora 08:00 e datës 18 shkurt 2007 deri në orën 24:00 të datës 20 shkurt 2007.

Neni 4

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr përsipër të identifikojë dhe të vërë në dispozicion të Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare listën e plotë të objekteve zgjedhore dhe adresat e sakta të vendndodhjes së tyre. Ky identifikim do të bëhet për çdo qendër votimi, KZQV dhe VNV në rang njësie vendore, rrethi dhe qarku.

Neni 5

KESH merr përsipër të përballojë dhe të eliminojë defektet e mundshme në linjat e saj gjatë kësaj periudhe në këto objekte, nëpërmjet punonjësve të degëve dhe nëndegëve vendore. Këta të fundit do të mbajnë kontakte të përhershme sidomos me drejtuesit e KZQV-ve dhe KQV-ve.

Neni 6

KQZ dhe KESH angazhohen të shqyrtojnë në mënyrë të ndërsjellë kërkesat dhe propozimet e dyanshme dhe të mbajnë kontakte të rregullta nëpërmjet strukturave përgjegjëse.

Neni 7

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, 30.1.2007

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot", Tel: 042 555 63; ose 04 267 468
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. **KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
2. **KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
3. **REGJISTRAT E NOTERISË**
4. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**
 1. **PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006) 1500**
 2. **PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) 600**
 3. **PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)..... 1300**
 4. **PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT..... 500**

BOTIME TË REJA

1. **TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000**
2. **TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500**
3. **TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000**
4. **TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500**
5. **PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË..... 1000**
6. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR..... 800**
7. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET..... 500**
8. **PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)..... 1000**
9. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE..... 500**

Hyri në shtyp më 5.2.2007
 Doli nga shtypi më 7.2.2007

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Grafon"
 Tiranë, 2007

Çmimi: 12 lekë